



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I" , Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 335/2 Prot.

Tiranë, më 21.07.2016

V E N D I M
Nr. 85, datë 21.07.2016

*“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,
filluar me Urdhrin nr. 335 prot., datë 18.04.2016”*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, referuar nenit 185, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE :

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas marrjes dijeni nga informacioni i dërguar prej Bashkisë Libohovë, për disa parregullsi të konstatuara si dhe me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, me aktin nr. 335 prot., datë 18.04.2016, “Për verifikimin e ligjshmërisë së procesit të rekrutimit në shërbim civil, në Bashkinë Libohovë”, ka filluar kryesisht verifikimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në këtë institucion.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në Bashkinë Libohovë nga grupi i punës i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Institucioni u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 335/1 prot., datë 18.04.2016 “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Bashkia Libohovë është organ i qeverisjes vendore i konstituuar pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015 dhe organizohet e funksionon, bazuar në ndarjen administrativo-territoriale (në rubrikën Qarku Gjirokastër, Qyteti Libohovë), të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas përcaktimeve të ligjit më sipër, kjo njësi e qeverisjes vendore përbëhet nga Bashkia Libohovë dhe dy Njësitë Administrative në varësi të saj, të cilat janë Qendër Libohovë dhe Zagorie (këto të fundit, ish-Komuna, të cilat janë shkrirë në të).

Bazuar në nenin 64, germa “j”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Këshilli i Bashkisë Libohovë, me aktin administrativ nr. 20, datë 14.01.2016 “Për Miratimin e strukturës dhe nivelin e pagave në Bashkinë Libohovë për vitin 2016”, i ndryshuar (me aktin nr. 35, datë 11.02.2016, të Këshillit Bashkiak), ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Libohovë dhe Njësi Administrative nën varësinë e saj.

Në vijim të zbatimit të këtij urdhri, kryetari i Bashkisë Libohovë, ka nxjerrë Urdhrin nr. 14, datë 29.01.2016, i ndryshuar (me aktin nr. 21, datë 26.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë), për miratimin dhe implementimin e strukturës dhe organigramës përfundimtare të bashkisë.

Sipas strukturës të mësipërme, në këtë bashki dhe njësitë administrative në varësi të saj, janë në total **66** pozicione pune, ndër të cilët rreth **14** pozicione pune, janë pjesë e shërbimit civil.

Nisur nga fakti se, në strukturën e institucionit nuk ishin specifikuar pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, si dhe për arsye se, njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore e institucionit nuk kishte realizuar një analizë për të përcaktuar numrin e pozicioneve të punës pjesë të shërbimit civil, si dhe të faktit që mungonin përshkrimet e punës, ky numër ka dalë duke u bazuar në emërtesën e pozicioneve të punës të përcaktuar në strukturën e bashkisë, kategorinë e pagës, si dhe detyrat që kryejnë realisht punonjësit në këto pozicione.

Gjatë procesit të verifikimit në institucionin nën inspektim, grupi i punës konstatoi se:

- Njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Libohovë, nuk i ka përcaktuar në strukturë pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil.
- Njësia përgjegjëse e bashkisë para konstituimit, nuk është shprehur për asnjë nga punonjësit ekzistues, në lidhje me statusin e tyre të punësimit, sipas detyrimit që rrjedh prej nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.
- Nga mos përfundimi i procedurës të verifikimit, rezulton se *punonjësi ******, emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil që në vitin 2002, i cili rezulton se nuk plotëson kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë, vazhdon punën në pozicionin “*Specialist i tatim-taksave*”.

- Duke u nisur nga aktet që u bënë të mundura për t'u verifikuar në këtë subjekt, rezulton se disa punonjës në këtë subjekt, trajtohen sipas Kodit të Punës, edhe pse kanë qenë punonjës ekzistues, pasi emërimi i tyre në pozicione pune pjesë të shërbimit civil, është kryer para fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Konkretisht bëhet fjalë për punonjësin *****, emëruar në vitin 2011, aktualisht në detyrën “Specialist i Bujqësisë” dhe punonjësin *****, emëruar në vitin 2011, aktualisht në detyrën “Veteriner”.
- Njësia e burimeve njerëzore e ish-Komunës Qendër Libohovë, ka kryer verifikimin e marrëdhënies së punës të personelit të saj. Nga ky verifikim kanë rezultuar 2 punonjës, të cilët i plotësojnë kushtet për të qenë nëpunës civil sipas përcaktimeve të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, për të cilët njësia është shprehur në lidhje me statusin e tyre të punësimit në shërbim civil. Konkretisht, bëhet fjalë për nëpunësit:
 - *****, deklaruar me aktin nr. 419, datë 17.12.2014, të njësisë përgjegjëse të ish-Komunës Qendër Libohovë, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve”;
 - *****, deklaruar me aktin nr. 490, datë 17.12.2014, të njësisë përgjegjëse të ish-Komunës Qendër Libohovë, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Financës”.
- Njësia e burimeve njerëzore të ish-Komunës Zagorie, që aktualisht është Njësi Administrative në varësi të Bashkisë në fjalë, nuk ka deklaruar statusin e punësimit për punonjësit që punonin në një vend pune pjesë të shërbimit civil, sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
- Njësia përgjegjëse e bashkisë, nuk ka kryer verifikimin e marrëdhënies së punës të personelit të Njësisë Administrative Zagorie transferuar pranë saj, pasi duke u bazuar në germën “c”, Kreu IV, të Vendimit nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave, ka marrë funksionet e organit përgjegjës për administrimin e personelit të ish-Komunës Zagorie të riorganizuar si pjesë e saj.
- Njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Libohovë, me aktin nr. 17, datë 15.02.2016, “Për planin e rekrutimit në shërbim civil”, ka planifikuar të kryejë procedurat e konkurrimit për 4 pozicione pune, pjesë e shërbimit civil. Nga verifikimi rezulton se, pozicionet e punës të plotësuar në kundërshtim me ligjin, nuk janë përfshirë në aktin administrativ të planifikimit të rekrutimit. Rezulton se, nga 4 pozicionet e punës të planifikuara për të plotësuar për vitin 2016, në 2 raste, janë krijuar vende të lira, pas daljes në pension të punonjësve aktualë.

Sa më sipër, gjatë inspektimit, u verifikua se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Libohovë, ka plotësuar 7 pozicione, pune pjesë të shërbimit civil, në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Këto emërime nuk janë kryer sipas një procedure konkurrimi të hapur, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil.

Nga verifikimi rezulton se, me miratimin e strukturës përfundimtare, Kryetari i Bashkisë Libohovë, me aktin administrativ nr. 22, datë 26.02.2016, ka emëruar me akt kolektiv gjithë

punonjësit e kësaj bashkie (*duke përjashtuar punonjësen ******) . Në aktin në fjalë, rezultojnë të trajtuar 2 nëpunësit që tashmë kanë statusin e nëpunësit civil (****** e ******); 2 punonjësit ekzistues (****** e ******); 1 punonjës pa arsim përkatës (*******); punonjësit administrativ dhe punonjësit që sipas ligjit trajtohen me Kodin e Punës, si dhe 6 punonjës, të cilët punojnë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të emëruar në kundërshtim me ligjin. Konkretisht funksionet e këtyre të fundit si dhe aktet e emërimit paraqiten, më poshtë:

1. *******, emëruar me aktin kolektiv nr. 22, datë 26.02.2016, pika 5, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar*”, emëruar fillimisht në pozicion pune pjesë e shërbimit civil me kontratën e datës 26.10.2014 dhe me vendimin nr. 19, datë 26.10.2015;
2. *******, emëruar me aktin kolektiv nr. 22, datë 26.02.2016, pika 6, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar*”, emëruar fillimisht në pozicion pune pjesë e shërbimit civil me vendimin nr. 11, datë 26.10.2015;
3. *******, emëruar me aktin kolektiv nr. 22, datë 26.02.2016, pika 16, në pozicionin “*Shef i Sektorit të Shërbimit Urban*”, emëruar fillimisht në pozicion pune pjesë e shërbimit civil me vendimin nr. 05, datë 24.08.2015;
4. *******, emëruar me aktin kolektiv nr. 22, datë 26.02.2016, pika 12, në pozicionin “*Specialist Juridik dhe Integrimi në BE*”, emëruar fillimisht në pozicion pune pjesë e shërbimit civil, me kontratë në datën 06.10.2015;
5. *******, emëruar me aktin kolektiv nr. 22, datë 26.02.2016, pika 21, në pozicionin “*Specialist i Tatim-Taksave*”, emëruar fillimisht në pozicion pune pjesë e shërbimit civil me kontratë në datën 16.11.2015, i cili rezulton se nuk plotëson kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë;
6. *******, emëruar me aktin kolektiv nr. 22, datë 26.02.2016, pika 20, në pozicionin “*Specialist i Tatim-Taksave*”, emëruar fillimisht në pozicion pune pjesë e shërbimit civil me vendimin nr. 7, datë 24.08.2015, i cili rezulton se nuk plotëson kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë;
dhe,
7. *Punonjësja ******, e cila nuk është listuar në urdhrin nr. 22, datë 26.02.2016, por është emëruar me Vendimin nr. 16, datë 02.03.2015, në detyrën “*Koordinatorë për të Drejtën e Informimit*”.

Në datën 28 maj 2016 ka hyrë në fuqi ligji nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i cili në nenin 185, “*Dispozita kalimtare*”, përcakton se, “*Për procedurat administrative, që kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar*”. Mbështetur në përcaktimet e kësaj dispozite, procedurat e nisura për verifikimin e emërimeve të kundërligjshme në Bashkinë Libohovë, do të vijojnë sipas dispozitave të ligjit të mëparshëm.

Në këto kushte, për gjithë sa u analizua më sipër, bazuar në nenin 23, pika 4, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar dhe në nenin 155/a dhe 116/c, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, i shfuqizuar, aktet administrative për emërimin e 7 punonjësve në pozicione pune pjesë të shërbimit civil, të

paraqitura në këtë relacion, të dalë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji për shërbimin civil, duhet të revokohen, si akte administrative absolutisht të pavlefshme.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, referuar nenit 185, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”; e nenin 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

T’i kërkojë njësisë përgjegjëse që për rregullimin e ligjshmërisë, e cila rezulton se nuk është zbatuar nga institucioni, pasi ka kryer emëtime në pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil, në kundërshtim me ligjin për shërbimin civil, të menaxhojë në përputhje me ligjin burimet njerëzore të institucionit duke zbatuar detyrat si më poshtë:

1. Fillimisht, njësia përgjegjëse, të përcaktojë pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil në bashki dhe në njësitë administrative në varësi të saj, duke u bazuar në funksionet dhe detyrat konkrete të vendeve të punës përkatëse të përcaktuara në formularin e përshkrimit të punës, nëse këto pozicione pune ushtrojnë funksione publike, duke përjashtuar rastet e përcaktuara në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Ky proces të materializohet në strukturën e miratuar nga Kryetari i institucionit me aktin administrativ nr. 14, datë 29.01.2016, i ndryshuar, duke u specifikuar në mënyrë të shprehur “Pozicion pune në shërbimin civil”.
2. Njësia përgjegjëse të kryejë verifikimin e marrëdhënieve të punës së personelit ekzistues të Bashkisë Libohovë dhe të Njesisë Administrative Zagorie, që kanë qenë të punësuar në pozicione pune pjesë të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014). Në këtë verifikim të përfshihen edhe 2 rastet e punonjësve ***** dhe ***** , të punësuar në pozicione pune pjesë të shërbimit civil që në vitin 2011. Për kryerjen e verifikimit njësia përgjegjëse të tregojë kujdes duke vepruar në këtë mënyrë:
 - a) Të plotësojë dosjen e personelit (*dosjen individuale*), të punonjësve, me të gjitha aktet e kërkuara sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.
 - b) Të deklarojë statusin e punësimit, duke pasur parasysh faktin që kanë filluar punë para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014),

që i plotësojnë kushtet për të qenë nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenin 67, të ligjit në fjalë, si dhe që plotësojnë kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë.

3. Në rastin e punonjësit, i cili nuk plotëson kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të bashkisë, të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit, duke drejtuar procesin për të revokuar pikën 19, të urdhrin nr. 22, datë 26.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë, që emëron punonjësin Arben Ismailati, në pozicionin “*Specialist i Tatim-Taksave*”, emëruar fillimisht në pozicion pune pjesë e shërbimit civil që në vitin 2002.
4. Njësia përgjegjëse, të revokojë aktet administrative, të cilët kanë dalë në kundërshtim me ligjin, për emërimin e përkohshëm të 7 punonjësve, si më poshtë:
 1. Të revokojë pikën 5, të aktit administrativ kolektiv nr. 22, datë 26.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Libohovë, për emërimin e punonjësit *****, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar*”;
 2. Të revokojë pikën 6, të aktit administrativ kolektiv nr. 22, datë 26.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Libohovë, për emërimin e punonjësës *****, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar*”;
 3. Të revokojë pikën 16, të aktit administrativ kolektiv nr. 22, datë 26.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Libohovë, për emërimin e punonjësit *****, në pozicionin “*Shef i Sektorit të Shërbimit Urban*”;
 4. Të revokojë pikën 12, të aktit administrativ kolektiv nr. 22, datë 26.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Libohovë, për emërimin e punonjësës *****, në pozicionin “*Specialist Juridik dhe Integrimi në BE*”;
 5. Të revokojë pikën 21, të aktit administrativ kolektiv nr. 22, datë 26.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Libohovë, për emërimin e punonjësit *****, në pozicionin “*Specialist i Tatim-Taksave*”;
 6. Të revokojë pikën 20, të aktit administrativ kolektiv nr. 22, datë 26.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Libohovë, për emërimin e punonjësit *****, në pozicionin “*Specialist i Tatim-Taksave*”;
 7. Të revokojë aktin administrativ nr. 16, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Bashkisë Libohovë, për emërimin e punonjësës *****, në detyrën “*Koordinatorë për të Drejtën e Informimit*”.
5. Njësia përgjegjëse, duhet të ndryshojë aktin administrativ nr. 22, datë 26.02.2016, për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2016, duke shtuar e konsideruar si vende vakante dhe pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil të plotësuar në kundërshtim me ligjin dhe ta publikojë atë në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, në faqet e tyre zyrtare dhe në stendat për njoftime publike të institucionit sipas përcaktimeve në Vendimin nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”.

Njësia përgjegjëse, në bazë të këtij plani duhet të zhvillojë procedurat e konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira, zbatimimi i të cilit do të ndiqet nga përfaqësuesit e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

6. Njësia përgjegjëse, të plotësojë pozicionet e punës që mbeten të lira, me anën e procedurave të konkurrimit të hapur sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, si procedura që përfaqësojnë sistemin e karrierës në shërbimin civil.

Njësia përgjegjëse gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike. Në veçanti, njësia përgjegjëse të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:

- a) Të krijohen Komisionet përkatëse të pranimit dhe vlerësimit (*Komiteti i Përherëshëm i Pranimit për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë*) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (*përveç lëvizjes paralele*) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.
- b) Të bëjë publike në faqen zyrtare, “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” dhe faqen zyrtare të Bashkisë Libohovë, ose nëse është e mundur, në stendat për publikun, shpalljet si:

- Aktin e shpalljes për të plotësuar një pozicion të lirë pune në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat, e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreu III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; pranim në shërbim civil; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit (*arsimi i lartë përkatës*); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjor që duhet të përmbajë shpallja.

- Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*” ashtu edhe për fazën e dytë “*pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”.
- Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (*lista përfundimtare*) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*” ashtu edhe për fazën e dytë “*pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”.
- Aktin e shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.

7. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Libohovë, të zbatojë vendimin brenda **30 ditëve** nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me aktet përkatëse, që materializojnë veprimet administrative përkatëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurremeve, si dhe për çdo problem tjetër që ka të bëjë me administrimin e shërbimit civil, të komunikojë me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe të kërkojë asistencën e nevojshme, me qëllim realizimin e këtyre proceseve në përputhje me ligjin.

8. Të njoftohet për këtë vendim, Bashkia Libohovë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA